

EC
MA NDRYSHE

RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS - 2025





RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË KOMUNËN E PRISHTINËS- 2025

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

049 714 024

Maj, 2026

Përmbajtja:

HYRJE.....	4
GJETJET E RAPORTIT	6
Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor	6
Korniza ligjore	7
Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit	8
Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor	9
Sistemet e monitorimit të mjedisit.....	11
Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore.....	12
Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike.....	12
Licencimi dhe lejet mjedisore.....	13
PËRFUNDIME.....	15
REKOMANDIMET.....	16

HYRJE

Metodologjia për monitorimin mjedisor në nivel komunal është hartuar si instrument profesional për vlerësimin sistematik të gjendjes së mjedisit dhe funksionimit të mekanizmave institucionalë në komunat e Kosovës. Dokumenti synon të krijojë një kornizë të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mjedisore, duke siguruar krahasueshmëri dhe koherencë ndërmjet komunave.

Kjo metodologji mbështetet në të dhëna primare të siguruar përmes pyetësorëve të strukturuar të plotësuar nga institucionet komunale përgjegjëse për çështjet mjedisore për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe në të dhëna sekondare të nxjerra nga raporte zyrtare komunale, dokumente institucionale dhe burime të tjera relevante që kontribuojnë në plotësimin dhe verifikimin e analizës.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë 12 ligje që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit

Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës

Ligji nr.08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Ligji nr.08/L-137 për pyjet e Kosovës

Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës

Ligji nr.04/L-060 për mbeturina dhe Ligji nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e tij

Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike

Ligji nr.08/L-065 për produktet biocide

Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë

Ligji nr.04/L-197 për kimikate

Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor

Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Metodologjia bazohet në analizën e këtyre komponentëve kryesorë të menaxhimit mjedisor:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Sistemet e monitorimit mjedisor
- Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore
- Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Në këtë kuadër, analiza synon të trajtojë në mënyrë të strukturuar elementet kryesore që rrjedhin nga legjisllacioni në fuqi dhe praktikat institucionale në nivel komunal.

Gjetjet e paraqitura në këtë dokument identifikojnë çështjet kryesore dhe sfidat aktuale në sektorin e mjedisit, duke reflektuar gjendjen reale në bazë të të dhënave të ofruara nga institucionet komunale. Këto gjetje evidentojnë nevojën për përmirësim të kapaciteteve institucionale, si dhe për forcimin e proceseve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor.

Në funksion të kësaj analize, në pjesën përfundimtare janë paraqitur rekomandime konkrete, të cilat synojnë përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe avancimin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal, drejt një qasjeje më të qëndrueshme dhe efektive në mbrojtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore.

GJETJET E RAPORTIT

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prishtinës, skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor është e shpërndarë në disa drejtori dhe sektorë të ndryshëm, të cilët trajtojnë aspekte të ndryshme të mjedisit në nivel lokal.

Strukturat kryesore që përfshihen në menaxhimin mjedisor janë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Menaxhimin e Hapësirave Publike dhe Parqeve, si dhe Drejtoria e Urbanizmit. Brenda këtyre strukturave funksionojnë sektorë të specializuar si Sektori i Mjedisit dhe Energjisë, Sektori i Menaxhimit të Mbeturisë dhe Ambientit, si dhe Sektori i Parqeve, të cilët mbulojnë fusha të ndryshme të mbrojtjes dhe menaxhimit të mjedisit në komunë.

Sa i përket kapaciteteve njerëzore, në këto struktura janë të angazhuar zyrtarë përgjegjës për çështjet mjedisore, përfshirë zyrtarë për mjedis, energji dhe menaxhim të hapësirave publike. Megjithatë, bazuar në të dhënat e pyetësorit, numri i stafit nuk vlerësohet i mjaftueshëm për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Në aspektin e përgatitjes profesionale, stafi vlerësohet në nivel shumë të mirë (5 nga 5), duke reflektuar ekzistencën e profileve të nevojshme profesionale për trajtimin e çështjeve mjedisore. Po ashtu, janë raportuar trajnime të organizuara si në fushën e kornizës ligjore, ashtu edhe në çështje mjedisore, megjithëse pa specifikim të detajuar të tyre.

Megjithatë, pavarësisht ekzistencës së strukturave të shumta institucionale, organizimi i shpërndarë i përgjegjësive ndërmjet drejtorive të ndryshme mund të ndikojë në koordinimin dhe efikasitetin e menaxhimit mjedisor në nivel komunal.

Organi komunal	Emri zyrtar	Fuqia punëtore
Drejtoria	Drejtoria e Shërbimeve Publike	1
Drejtoria	Drejtoria për Menaxhimin e Hapësirave Publike dhe Parqeve	1
Drejtoria	Drejtoria e Urbanizmit	4
Spektori	Spektori i Mjedisit dhe Energjisë	/
Zyrtar	U.D. Shefe e Spektorit - Jehona Mavraj	1
Zyrtar	Zyrtare e Lartë për Mjedis - Fatbardha Mehmetukaj	1
Zyrtar	Zyrtare për Mjedis - Trime Leci	1
Zyrtar	Zyrtare për Efiçiençë të Energjisë - Shyhrete Abazi	1
Spektori	Spektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe Ambientit	5
Zyrtar	Zyrtare e Lartë për Ambient - Seniha Bajraktari	1
Spektori	Spektori i Parqeve	/
Zyrtar	Zyrtar mjedisor - Sokol Sallahu	1

Tabela 1. Skema institucionale lokale për menaxhimin mjedisor - Komuna e Prishtinës

Korniza ligjore

Komuna e Prishtinës në planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbështetet në legjislacionin në fuqi në nivel qendror, duke përfshirë Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Korniza ligjore mjedisore vlerësohet si pjesërisht e konsoliduar, duke reflektuar ekzistencën e një baze ligjore funksionale, por edhe nevojën për përditësim dhe përmirësim të mëtejshëm të saj. Në këtë drejtim, janë identifikuar mangësi që lidhen me vjetërsimin e disa ligjeve, çka ndikon në zbatimin efektiv të tyre në nivel komunal.

Sa i përket njohurive të stafit lidhur me kornizën ligjore, ato vlerësohen në nivel të mirë (4 nga 5), duke treguar se ekziston një bazë solide

njohurish, por që kërkon zhvillim të mëtejshëm për përballimin e sfidave komplekse mjedisore.

Në përgjithësi, edhe pse ekziston një bazë ligjore e mjaftueshme për menaxhimin e mjedisit, sfidat në përditësimin dhe zbatimin e saj mbeten një element që ndikon në efikasitetin e politikave mjedisore në nivel lokal.

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Prishtinës ka hartuar dokumente të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor që rrjedhin nga korniza ligjore në fuqi. Ndër dokumentet e identifikuara përfshihet Rregullorja për Planifikim Mjedisor, e cila shërben si bazë për orientimin e politikave dhe veprimeve në këtë fushë.

Sa i përket harmonizimit të dokumenteve, është evidentuar se strategjitë mjedisore nuk hartohen në nivel komunal, por në nivel qendror, çka kufizon rolin e komunës në zhvillimin e politikave strategjike mjedisore dhe orienton atë kryesisht në zbatim të tyre.

Komuna e Prishtinës gjatë vitit të shkuar nuk ka raportuar se ka Plan për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, dhe as program lokal për mbrojtjen e natyrës. Gjithashtu nuk ka ndarë buxhet për mbrojtje të mjedisit. Ndërkohë zyrtarët kanë theksuar se kjo komunë ka Plan lokal të veprimit për cilësinë e ajrit; Plan komunal për menaxhimin e mbeturinave; Plan komunal për efikasitet të energjisë si dhe Plan komunal për energji dhe klimë.

Në aspektin e zhvillimit të projekteve, Komuna e Prishtinës ka realizuar iniciativa konkrete për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, ndër të cilat përfshihen projekte si “City Experiment Fund” dhe “Pyllëzimi i Zonave të Zhveshura”, që synojnë rritjen e sipërfaqeve të gjelbra dhe përmirësimin e kushteve mjedisore në territorin e komunës.

Gjithashtu, janë ndërmarrë masa konkrete për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë aktivitete të gjelbërimit, si mbjellja e 100 mijë kurorave gjelbëruese, fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete të tjera mjedisore që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe rritjen e vetëdijes publike.

Në përgjithësi, megjithëse komuna ka një rol aktiv në zbatimin e projekteve dhe masave mjedisore, mungesa e zhvillimit të strategjive në nivel lokal kufizon planifikimin afatgjatë dhe integrimin e plotë të politikave mjedisore në nivel komunal.

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Në Komunën e Prishtinës realizohet inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e mjedisit, duke reflektuar një nivel funksional të mbikëqyrjes institucionale në këtë fushë.

Po ashtu, hartohen raporte të inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore, të cilat shërbejnë si bazë për monitorimin e gjendjes mjedisore dhe identifikimin e problemeve në terren.

Nga ana tjetër, nuk hartohen raporte të monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore, çka paraqet një mangësi në aspektin e ndjekjes sistematike të politikave dhe masave mjedisore në nivel komunal.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike. Po ashtu, janë realizuar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese në mjedis nga kompani private, ndërsa komuna aktualisht është në fazën e sigurimit të lejes mjedisore komunale për deponinë e mbeturinave të vëllimshme.

Sipas të dhënave të raportuara, nuk janë identifikuar raste të çrregullimeve mjedisore nga aktivitetet e personave fizik apo juridik, si dhe nuk janë raportuar raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara.

Në përgjithësi, megjithëse ekziston një sistem funksional i inspektimit dhe monitorimit në disa aspekte, mungesa e raportimit të zbatimit të strategjive dhe e evidencave për çrregullime mjedisore kufizon një pasqyrë të plotë dhe të detajuar të gjendjes mjedisore në komunë.

Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Prishtinës përbën një nga komponentët kryesorë të menaxhimit mjedisor, duke reflektuar nivelin e zhvillimit urban dhe presionin e lartë mbi shërbimet publike. Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), paraqitet një analizë krahasuese për vitet 2023 dhe 2024, e fokusuar në sasinë e mbeturinave të gjeneruara, treguesit për banor dhe mbulimin me shërbim.

Në këtë kontekst, për të siguruar përputhshmëri metodologjike dhe interpretim të saktë të të dhënave, analiza bazohet në numrin e banorëve të përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave, si bazë për llogaritjen e treguesve për banor.

Treguesi	2023	2024	Ndryshimi
Numri i banorëve të shërbyer	368,284	280,822	-87,462
Sasia e mbeturinave (ton/vit)	89,840	81,797	-8,043
Sasia e mbeturinave (kg/vit)	89,840,000	81,797,000	-8,043,000
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/vit)	243.94	291.28	+47.34
Gjenerimi i mbeturinave (kg/banor/ditë)	0.67	0.80	+0.13
Shkalla e mbulimit me shërbim (%)	100%	100%	0%

Tabela 2 Statistikat kryesore për menaxhimin e mbeturinave - Komuna e Prishtinës

Shënim: Të dhënat për vitin 2024 i referohen banorëve të shërbyer dhe jo popullsisë totale.

Të dhënat tregojnë se Komuna e Prishtinës ka një nivel të lartë të mbulimit me shërbim të mbeturinave, duke ruajtur 100% mbulim për të dy vitet. Megjithatë, vërehet një rënie në sasinë totale të mbeturinave të

grumbulluara nga viti 2023 në vitin 2024, ndërsa në të njëjtën kohë është rritur gjenerimi i mbeturinave për banor.

Kjo situatë lidhet kryesisht me dallimet në mënyrën e raportimit të të dhënave për popullsinë ndërmjet viteve, si dhe me ndryshimet në numrin e banorëve të përfshirë në shërbim. Rritja e indikatorëve për banor nuk reflekton domosdoshmërisht rritje reale të mbeturinave, por ndikohet nga baza e përdorur për llogaritje.

Në përgjithësi, sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Prishtinë paraqitet funksional, por kërkon përmirësim në harmonizimin e të dhënave dhe në analizën e indikatorëve për planifikim më të saktë.¹

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Sistemet e monitorimit të mjedisit

Në Komunën e Prishtinës ekziston sistem i monitorimit të cilësisë së ajrit, i cili realizohet përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), duke reflektuar një nivel të institucionalizuar të monitorimit për këtë komponent mjedisor.

Sipas të dhënave, në territorin e komunës janë funksionale dy stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit, ndërsa mbikëqyrja e cilësisë së ajrit realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga IHMK.

Në anën tjetër, Komuna e Prishtinës nuk posedon sistem të monitorimit të cilësisë së dheut dhe nuk realizohet mbikëqyrje sistematike në këtë aspekt, çka paraqet një boshllëk në monitorimin e komponentëve të rëndësishëm mjedisorë.

¹ Raporti i AMMK për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë, publikuar në vitin 2025, linku: <https://ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/ALB%20Raporti%20per%20gjendjen%20e%20mbeturinave%20ne%20Kosove%202023-2024.pdf>

Po ashtu, nuk ekziston sistem i monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në nivel komunal, ndërsa monitorimi i ujit realizohet nga institucione të tjera, siç është kompania rajonale e ujësjellësit “KRU Prishtina”.

Në përgjithësi, monitorimi i mjedisit në Komunën e Prishtinës është i zhvilluar vetëm për komponentin e ajrit, ndërsa për komponentët e tjerë, si dheu dhe uji, mungojnë sisteme të strukturuar dhe mbikëqyrje sistematike, çka kufizon krijimin e një pasqyre të plotë të gjendjes mjedisore në nivel komunal.

Sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore

Komuna e Prishtinës nuk ka ndërtuar sistem të strukturuar për menaxhimin e të dhënave mjedisore, çka paraqet një boshllëk në organizimin dhe ruajtjen sistematike të informacionit në këtë fushë.

Megjithatë, sipas të dhënave të raportuara, departamenti posedon kapacitetet e nevojshme teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, duke reflektuar potencial për zhvillimin e sistemeve më të avancuara në të ardhmen.

Në përgjithësi, mungesa e një sistemi të integruar për menaxhimin e të dhënave kufizon efikasitetin e analizës, raportimit dhe planifikimit të bazuar në evidencë në nivel komunal, pavarësisht kapaciteteve ekzistuese njerëzore dhe teknike.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vlerësohet në nivel mesatar (3 nga 5), duke reflektuar një nivel të moderuar të përfshirjes dhe bashkëpunimit institucional.

Po ashtu, bashkëpunimi me nivelin qendror në hartimin e strategjive mjedisore vlerësohet gjithashtu në nivel mesatar (3 nga 5), duke treguar një përfshirje të kufizuar të komunës në proceset strategjike.

Ndërkohë, bashkëpunimi me organizatat joqeveritare vlerësohet në nivel të lartë (5 nga 5), duke reflektuar një angazhim të mirë të komunës në bashkëpunim me sektorin civil për çështje mjedisore.

Në aspektin e pjesëmarrjes publike, Komuna e Prishtinës zhvillon procese të konsultimit publik gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor. Këto procese përfshijnë iniciativa si konsultimet për Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), vlerësimet strategjike mjedisore dhe procese të tjera planifikuese në zona të ndryshme të qytetit.

Niveli i pjesëmarrjes publike në këto procese vlerësohet në nivel mesatar (3 nga 5), duke reflektuar një përfshirje të moderuar të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Në përgjithësi, edhe pse ekziston një nivel i mirë bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe zhvillohen procese të konsultimit publik, bashkëpunimi me nivelin qendror dhe pjesëmarrja e qytetarëve mbeten fusha që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Licencimi dhe lejet mjedisore

Në Komunën e Prishtinës realizohet procesi i lëshimit të lejeve mjedisore komunale, në përputhje me kompetencat dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Sipas të dhënave të raportuara, komuna posedon gjithsej 95 leje mjedisore komunale aktive, të cilat lidhen me aktivitete të ndryshme që ndikojnë në mjedis dhe kërkojnë kontroll institucional.

Kjo tregon se procesi i licencimit është funksional dhe paraqet një mekanizëm të rëndësishëm për kontrollin dhe menaxhimin e aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis në nivel lokal.

Megjithatë, mungesa e të dhënave të detajuara mbi llojin dhe shpërndarjen e këtyre lejeve kufizon analizën më të thelluar të ndikimit të tyre në mjedis dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

PËRFUNDIME

Nga analiza e të dhënave për Komunën e Prishtinës evidentohet se ekziston një bazë institucionale e zhvilluar për menaxhimin mjedisor, e karakterizuar nga përfshirja e disa drejtorive dhe sektorëve të specializuar. Megjithatë, kjo strukturë e shpërndarë ndikon në koordinimin dhe efikasitetin e përgjithshëm të menaxhimit mjedisor.

Në aspektin ligjor dhe institucional, ekziston një bazë funksionale, por me mangësi që lidhen me përditësimin e legjislacionit dhe me përfshirjen e kufizuar të nivelit lokal në hartimin e strategjive mjedisore.

Komuna shfaq angazhim në zbatimin e projekteve dhe masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht në fushën e gjelbërimit dhe ndërgjegjësimit publik. Megjithatë, mungesa e sistemeve të integruara për monitorimin e të gjithë komponentëve mjedisorë dhe për menaxhimin e të dhënave paraqet një pengesë për planifikim të bazuar në evidencë.

Po ashtu, edhe pse ekziston një nivel i mirë bashkëpunimi me organizatat joqeveritare, bashkëpunimi me nivelin qendror dhe përfshirja e qytetarëve mbeten fusha që kërkojnë përmirësim.

Në përgjithësi, menaxhimi mjedisor në Komunën e Prishtinës karakterizohet nga kapacitete ekzistuese dhe aktivitete konkrete, por edhe nga sfida strukturore që lidhen me koordinimin, monitorimin dhe planifikimin strategjik.

REKOMANDIMET

1. Të forcohet koordinimi ndërinstytucional ndërmjet drejtorive dhe sektorëve që trajtojnë çështjet mjedisore, me qëllim rritjen e efikasitetit të menaxhimit mjedisor.
2. Të zhvillohen dokumente strategjike mjedisore në nivel komunal, në përputhje me politikat qendrore, për të mundësuar planifikim afatgjatë dhe të integruar.
3. Të krijohet një sistem i integruar për monitorimin e të gjithë komponentëve mjedisorë, përfshirë ajrin, ujin dhe dheun.
4. Të ndërtohet një sistem funksional për menaxhimin e të dhënave mjedisore, me qëllim përmirësimin e analizës dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë.
5. Të rritet transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse përmes zgjerimit të mekanizmave të konsultimit publik.
6. Të forcohet bashkëpunimi me nivelin qendror dhe institucionet përkatëse për zbatimin më efektiv të politikave mjedisore.
7. Të avancohen mekanizmat e licencimit dhe monitorimit të aktiviteteve që ndikojnë në mjedis, përmes rritjes së kontrollit dhe raportimit.

Për EC:

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse. Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar. Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-it synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

EC
MA ND RYSHE



www.ecmandryshe.org